




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 873/23
Dt. 24.08.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. "Grandelite" sh.p.k. me seli në Prishtinë, kundër Njoftimit mbi Vendimin e A.K. të dt. 14.08.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63 paragrafi 63.1.2 të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik, më datën 24.08.2023 bie këtë:

V E N D I M

- 1. Apropohet** pjesërisht si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e datës 21.08.2023, e subjektit në procedurë: "Grnadelite L.L.C." & "Quatro Trade" sh.p.k. & "Udha" sh.p.k. me seli në Prishtinë, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit në aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança dhe lumenjve në fsh. Studime dhe Smrekonicë" me nr. të prokurimit: VU644 – 23 – 7150 – 511 dhe Nr. i brendshëm: VU644 – 23 – 070 – 511
- 2. Autoritetit Kontraktues** – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63 paragrafi 63.1.2 të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik do të ndërmarr veprimet procedurale në pajtim me dispozitat e LPP-së që rregullojnë këtë çështje.
- 3. Vendimi** hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik më dt. 14.08.2023 në Platformën elektronike E-prokurimi ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e A.K. për aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança dhe lumenjve në fsh. Studime dhe Smrekonicë" me nr. të prokurimit: VU644 – 23 – 7150 – 511 dhe Nr. i brendshëm: VU644 – 23 – 070 – 511

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek.- Ankuesi, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjore, Ankuesi konsideron se me rastin e marrjes së vendimit të dt. 14.08.2023 janë shkelur dispozitat e: nenit 7 – Barazia në Trajtim, nenit 10 – Mjetet për promovimin e transparencës, nenit 27 – Dosja e Tenderit – nenit 52 – Njoftimi i Kriterëve për Dhënie të Kontratës, nenit 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, nenit 60 – Kriteret për Dhënie të Kontratës dhe nenit 65 – Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve, sepse, sikurse pretendon Ankuesi, vlerësimi i tenderëve nuk është bërë në plotni dhe në pajtim me nenin 59 të LPP-së, rrjedhimisht sipas Ankuesit, dokumentacioni tenderik i Ankuesit nuk është vlerësuar saktë dhe drejtë ndërsa, sipas Ankuesit O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i përmbushë kërkesat e saktësuara në FTD – Kërkesat nga neni 9.1 lidhur me 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale.

Autoriteti Kontraktues, pasi i shqyrtoi pretendimi e Ankuesit të parashtruar në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimi të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është pjesërisht e bazuar, duke konstatuar me sa vijon:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Sipas nenit 1 të LPP-së, A.K. ka pasur për qëllim që, bazuar në kushtet dhe rregullat e specifikuara, procedurën e zbatuar, të siguroj mënyrën më efektive më transparente dhe më të drejtë të realizoi shfrytëzimin e fondeve publike dhe burimeve publike të A.K. Neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, neni 33 paragrafi 1

(Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve, të vendosë në mënyrë meritore. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 14.08.2023 është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent.

Pretendimi i Ankuesit se, me rastin e vlerësimit të dokumentit Kontratë bashkëpunimi dhe Autorizim / Deklaratë për Udhëheqësin e Bashkimit të Përkohshëm Ekonomik, A.K. ka vlerësuar dhe / ose interpretuar gabimisht dokumentin sepse, sipas Ankuesit Udhëheqës i Grupit të O.E. duhet të jetë O.E. “ Udha “sh.p.k. dhe jo ‘ Grandelite “sh.p.k., sikurse vlerëson A.K. është i pabazë dhe jo i saktë. Në fakte dokumentet e dorëzuara bashkangjitur me Dosjen e Tenderit tregojnë dhe saktësojnë qartë se Udhëheqës i Bashkimit të Grupit , sikurse është saktësuar në Autorizim, është shoqëria “ Grandelit L.L.C. “. Andaj, bazuar në këtë fakt, sikurse ka konstatuar A.K. , vlerësimet e dokumenteve të dorëzuara lidhur me përmbushjen e Kërkesave të specifikuar nga A.K. në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD, neni 9.1 lidhur me 9.2 pika 1 si dhe gjetjet e konstatuara në Vendimin e A.K. Nr. 783/23 dt. 09.08.2023 janë të drejta dhe të sakta ndërsa, pretendimet e Ankuesit lidhur me këtë çështje janë të pabazuar dhe si të tilla janë refuzuar.

Sa i përket pretendimit të Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk përmbushë Kërkesat e saktësuar në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD, neni 9.1 lidhur me 9.2 , pika 1, Lista e Kontratave të realizuara, me theks të veçantë sa i përket Kërkesës së A.K. që Lideri i Grupit të OE. të ketë përmbushur 60 % të vlerës prej 700,000.00€ të projekteve të përfunduara, A.K. vlerëson si pjesërisht të bazuar dhe , në procedurën e rivlerësimit të tenderëve do të ketë kujdes që të zbatohen dispozitat e LPP-së në plotni , në veçanti të nenit 59 lidhur me ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve ashtu që të arrihet deri te një vendim sa më i qartë, i drejt dhe në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-së.

Pretendimi i Ankuesit se Plani për menaxhimin e trafikut nuk paraqet dokument të rregullt sepse , sikurse theksohet në Kërkesën për Rishqyrtim, nuk plotëson kushtet sipas FTD-së sepse nuk është i detajuar, nuk është i përcjallë me skica dhe shenja përkatëse të trafikut rrugorë, sikurse vlerëson A.K. pretendimi ankimorë është i pabazuar për faktin se kërkesa të tilla sikurse u theksuan më lartë nuk janë specifikuar në Kërkesën nr. 5 të FTD-së prandaj një pretendim i tillë është refuzuar sepse A.K. nuk mundë të refuzoi një tender për ndonjë kërkesë e cila nuk është specifikuar në FTD, duke qenë se dokumenti i tillë është i nënshkruar nga Inxh. i komunikacionit, z. Florim Shala.

Ndërsa, sa i përket pretendimit lidhur me diplomën e Inxhinjerin e Ambientit z. Ruzhdi Feka, A.K. vlerëson se kërkesa e saktësuar në FTD ka qenë min. Bachelor i ambientit ndërsa O.E. i rekomanduar për dhënie kontrata ka dëshmuar me dokumente valide (diplomë, CV dhe Kontratë mbi Veprën, se ka bashkëpunim me stafin i cili ka shkallën e kualifikimit Master – **Inxhinjer i mbrojtjes së mjedisit**, që sikurse ka vlerësuar A.K. është, është plotësisht në harmoni me kërkesën e saktësuar në Dosjen e Tenderit , pjesa FTD , neni 9.1 lidhur me 9.2 pika 2 nënpika (D)

Gjithashtu edhe pretendimi lidhur me kontratat e stafit të punëtorëve teknik, sikurse ka vlerësuar A.K., nuk është i bazuar për faktin se, kontratat e punës, me theks të veçantë Kontratat mbi Veprën, janë dokumente që angazhojnë punëtorin për projektin i cili është i specifikuar dhe emërtuar dhe me klauzolën , citat : “ **përuddha e ekzekutimit nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e saj** “ mbarim citati, që për A.K. , sikurse është vlerësuar , është e mjaftueshme dhe paraqet dokument të rregullt dhe të pranueshëm për faktin se nuk ka një datë të saktë se kur do të lidhet kontrata dhe në cilin afat kohorë do të përfundoj ekzekutimi i punimeve sipas kontratës.

Sa i përket pretendimit të Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës, në ofertën e tij financiare respektivisht në Paramasë/Parallogari, në pozicionin 4.3 – Punët e armaturës, ka ofruar çmim jo-normalisht të ulët, A.K. vlerëson se në procedurën e rivlerësimit të tenderëve, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të tenderëve do të ketë parasysh edhe çështjen e pozicionit – Punët e armaturës dhe do ta trajtoj në kuptim dhe në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së që e trajtojnë dhe rregullojnë këtë çështje, andaj edhe ky pretendim ankimorë u vlerësua si pjesërisht i bazuar.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 63 paragrafi 63.1.2 të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrori Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 070/2023, datë 24.08.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkiviti (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj